

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Datë:	31.12.2025
Për:	Divizioni për Integritet dhe Strategji, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;
CC:	z.Shaqir TOTAJ, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Nga:	znj.Emine Gashi, Zyrtare përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit të Komunës së Prizrenit <i>Emine Gashi</i>
Tema:	Raporti gjashtëmujor 01 Korrik - 31 Dhjetor 2025, për Plan të Integritetit 2025

Në zbatim të Udhëzuesit për Monitorimin dhe Raportimin e Zbatimit të Planit të Integritetit, sipas Vendimit Nr.704/2024 të datës 16.05.2024, me qëllim të raportimit të Planit të Integritetit 6 mujor. Përkatësisht për gjashtëmujorin e dytë të vitit (01 Korrik – 30 Dhjetor 2025), më datë 31.12.2025 paraqes këtë:

RAPORT

Ky raport është hartuar me qëllim të pasqyrimit të progresit dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit për Komunën e Prizrenit për periudhën 2024-2026. Në përputhje me kërkesat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe dokumentin strategjik të miratuar nga Komuna, monitorimi i vazhdueshëm është një komponent kyç për sigurimin e efektshmërisë së masave të ndërmarra.

Ky raport përmban një analizë të performancës dhe aktiviteteve të kryera gjatë periudhës 01 Korrik – 31 Dhjetor 2025 nga Komuna e Prizrenit, në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit.

Qëllimi i këtij raporti është të ofroj një pasqyrë të rezultateve kryesore për periudhën e dytë gjashtëmujore, duke evidentuar arritjet kryesore, sfidat, afatet kohore si dhe rreziqet që janë hasur gjatë implementimit të planit.

Të dhënat janë analizuar për të vlerësuar efektivitetin e masave të marra për të siguruar integritetin dhe për të identifikuar zonat që kërkojnë përmirësime të mëtejshme. Raporti përfundon me rekomandime për veprime të ardhshme që synojnë përmirësimin e mëtejshëm të procesimit dhe minimizimin e rreziqeve gjatë viteve në vazhdim.

Matrica e dërguar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është plotësuar nga Komuna e Prizrenit.

Procesi ka kërkuar kohë dhe ka hasur disa vështirësi, por janë tejkaluar dhe është përfunduar me sukses në mbledhjen e të dhënave.

Në kuadër të vlerësimit të fushave të rrezikut sipas Planit të Integritetit, konstatohet se dy (2) fusha të rrezikut mbeten të porealizuara, për shkak të faktorëve objektivë dhe nevojës për masa shtesë institucionale. Njëzet e shtatë (27) fusha të rrezikut janë pjesërisht të realizuara, ku aktivitetet dhe masat e parapara janë në proces të zbatimit dhe do të vazhdojnë të trajtohen edhe në periudhën në vijim. Ndërkohë, njëzet e një (21) fusha të rrezikut janë realizuar plotësisht, duke reflektuar angazhim dhe zbatim efektiv të masave të planifikuara.

Ky raport – matrica në vijim ofron një pasqyrë të detajuar të përparimit dhe sfidave në implementimin e masave për menaxhimin e rreziqeve në Komunën e Prizrenit.

Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Planifikimi dhe menaxhimi financiar	Ndikimi i vendimarrjes nga niveli qendror në nivelin lokal në zvogëlimin e efikasitetit në punët e komunës	Intensifikimi i takimeve për koordinim në vendimarrje në mes të dy niveleve dhe marrja e masave ligjore.	ZKA dhe ZKF	2026	Njoftimi në Ministri të Financave për ekzekutimin e lendeve përmbartimore	Pjesërisht e Realizuar		Ekzekutimi jo adekuat i buxhetit për lëndet përmbartimore sipas vendimeve gjyqësore	Ekzekutimi i lendeve përmbartimore nëpër kategorit adekuate ekonomike
	Mos Planifikimi në detale i planit të shpenzimeve	Takime vetëdijësuese me stafin në hartimin e planit të zotimeve dhe shpenzimit;	Programet dhe nën programet	2026	Njoftimi i drejtorive dhe zyrtareve për planifikim adekuat të shpenzimeve	Pjesërisht e Realizuar		Mungesa e stafit profesional	Rekomandojmë trajnime për stafin e nivelit profesional
	Mos koordinimi i drejtorive/njësive në fushën e planifikimit buxhetore, barazimi i të hyrave	Formimi i grupeve punuese profesionale në fusha të caktuara, caktimi i zyrtarëve për barazime në të hyra	ZKA dhe Drejtorët	2026	Organizimi i takimeve për planifikim sa më të drejtë të buxhetit	Pjesërisht e Realizuar		Trajnimi i zyrtarëve të cdo drejtorive për Planifikim të buxhetit dhe barazim të të Hyrave	Rekomandojmë trajnime për stafin e nivelit profesional
	Mangësi në procesin e inventarizimit dhe regjistrimit të pasurisë komunale	Rregulloria NR. 02/2013- Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore	Formimi i komisionit për inventarizim në afatin e duhur, zyrtarët përgjegjës Regjistrimi i të gjitha pagesave kapitale në sistemin SIMFK	2026	Komisioni do të formohet me kohë për inventarizimin e pasurisë	Pjesërisht e Realizuar		Nuk kemi informata të sakta lidhur me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë	Formimi me kohë i komisionit dhe regjistrimit sipas dative të parapara në rregullore

Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Auditimi i brendshëm	Mos përgatitja e propozim-planeve strategjike dhe vjetore të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut	Hartimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit në bazë të regjistrit të azhurnuar të rrezikut.	Njësia e Auditimit (hartimi i planeve) Kryetari i Komunës (miratim), dhe Komiteti i Auditimit (miratim).	2025	Plani strategjik dhe vjetor 2025-2027 është përgatitur mbi bazën e vlerësimit të rrezikut.	E Realizuar	- Ligji për kontroll të brendshëm të financave publike 06/L021 Linkun mund ta gjeni në web faqen e ministries se financave tek departamenti Qendror per harmonizimi e Auditimit te Brendshem	Regjistri i rrezikut nuk është i azhurnuar në nivel komune sipas periudhave te parapra.	Të sigurohet azhurnimi periodik i regjistrit të rrezikut
	Mos përfshirja në planin strategjik dhe vjetor të punës e të gjitha fushave (sistemeve, drejtorive) për auditim për shkak të pamjaftueshmërisë së auditorëve të brendshëm	Rekrutimi i së paku një auditori shtesë.	Kryetari i Komunës, Njësia për burime njerzore	2026	Kërkesa të vazhdueshme zyrtare për rritje të stafit. Referenca: Plani Strategjik dhe vjetor 2025-2027, shkresat e komunikimit me kryetarin, raportet e K, kërkesat per planin e personelit 2025 etj	Pjeserisht e Realizuar	Ligji për kontroll të brendshëm të financave publike 06/L021, rregullorja qrk-nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit public Linkun mund ta gjeni në web faqen e ministries se financave tek Departamenti Qendror per harmonizimi e	Mos shpallja e konkursit për auditorë. Gjendja e tanishme e personelit të auditimit në Komunë është e përbërë nga udhëheqësi i NjAB-së dhe një auditor i brendshëm.	Të bëhet vlerësim i kapaciteteve dhe të planifikohet rekrutimi. Të parashikohet rekrutimi i auditorëve të rinj Të ofrohen trajnime për përmirësimin e kapaciteteve të stafit ekzistues.

							Auditimit te Brendshem		
	Hartimi i planeve të veprimit në mënyra jo të duhur nga menaxhmenti, mangësi në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, përgatitja dhe dorëzimi jo me kohë të raporteve për rishikim të rekomandimeve.	Formimi i grupeve punuese për hartimin e Planeve të Veprimit për dhe monitorimi i rregullt të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.	Kryetari i Komunës, Drejtorët e drejtorive, Anëtarët e grupit punues për zbatimin e rekomandimeve	2025	Planet e veprimit janë dorëzuar me kohë për auditimet e realizuara. Është bërë monitorimi sipas afateve të dhëna në planet e veprimit dhe afateve të përcaktuara në rregulloren për zbatimin e rekomandimeve	E Realizuar	Ligji nr. 06/L-021 për kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, të aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm, Procedurat Standarde të Operimit mbi trajtimin e të gjeturave dhe zbatimit të rekomandimeve, të nxjerrë nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm Linkun mund ta gjeni në web faqen e ministries së financave tek departamenti Qendror për harmonizimi e Auditimit të Brendshëm dhe në web faqen e Zyres Kombëtare të Auditimit	Keqkuptime rreth procesit të planeve të veprimit, sepse në disa raste e e ngatërrojnë me komentet në draft të cilat menaxhmenti ka obligim të përgjigjet. Megjithatë edhe kjo qështje në vazhdimësi po përmisohet, falë inistimit të AB gjatë komunikimit me menaxhmentin e Komunes	Të përmirësohet cilësia e planeve të veprimit, të përcaktohen qartë me objektivat dhe afate për zbatim.

	Mungesa e koordinimit ndërmjet Njesisë së AB, Komitetit të Auditimit, Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive	Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njesisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. Vështirësi në komunikim kohe pas kohe mund të ketë me drejtorët e drejtorive komunale	Kryetari i Komunës, Komiteti i Auditimit, Komiteti i Auditimit dhe Drejtorët e Drejtorive.	2026	Takime dhe komunikim i vazhdueshëm me drejtorët dhe udhëheqesit e zyrave komunale.	Pjesërisht e Realizuar	Ligji 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, UA MF nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Rregullore (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm. Linkun mund ta gjeni në web faqen e ministries së financave tek departamenti Qendror për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	Mos kthimi i përgjigjeve brenda afateve paraqesin disa nga vështirësitë të cilat ndikojnë që auditimet mos të përfundojnë sipas afateve të parapara në planin e auditimit.	Të krijohen mekanizma formal të raportimit. Kryetari dhe menaxhmenti duhet të garantojnë mbështetje dhe angazhim aktiv për nxitjen e bashkëpunimit dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet

Komunikimi, informimi dhe ruajtja e të dhënave dhe dokumenteve	Mos funksionimi i ueb faqes zyrtare te Komunës.	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht MAPL-në dhe ASHI-në.	Zyra e Kryetarit	2025	Ueb faqja nuk menagjohet nga Komuna e Prizrenit dhe nuk kemi asnjë mundësi që të bëjmë ndonjë veprim, në vazhdimësi komunikojmë me ASHI-në	E Realizuar	Udhëzimet administrative në fuqi	Kohë pas kohe ka vështirësi, por që nuk janë vështirësi që e bllokojnë gjithë procesin.	ASHI dhe MAPL janë duke e hartuar webfaqen e re, rekomandimet i kam dhënë në puntorit që i kemi mbajtur me personat përgjegjës.
	Pamundësia e publikimit të dokumenteve që lidhe me afate ligjore.	Komunikimi i vazhdueshëm me përgjegjësit e mirëmbajtjes së ueb-faqes zyrtare, përkatësisht MAPL-në dhe ASHI-në.	Zyra e Kryetarit	2025	Të gjitha dokumentet janë publikuar sipas afateve ligjore	E Realizuar	Aktet nënligjore	Herë pas here na paraqitetn vështirësit për publikime sipas afateve ligjore, por që publikimet bëhen në kuadër të legjislacionit që është në fuqi.	Webfaqja e re e komunës është lëshuar në përdorim por që vazhdon të ketë problem në funksionim-ASHI i ka këto informacione dhe se në vazhdimësi bëjnë përprjekje që të evitohen këto probleme.
	Mungese e sigurisë se te dhënave, duke përfshirë humbjen e te dhënave.	Rritja e sigurisë së të dhënave nëpërmjet avancimit të sistemit të sigurisë dhe rritjes se kapaciteteve arkivuese të këtij sistemi	Zyra e Kryetarit	2025	Të dhënat personale janë ruajtur në lartësinë e përgjegjësis dhe kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale	E Realizuar	Ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret komunale	ASHI, në vazhdimësi ka bërë përprjekje që të rris sigrinë dhe besoj që ja ka arritur qellimit që të rris kapacitetet e saja për të ruajtur të dhënat.	Mbajtja e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës
	Mungese e trajnimeve se si të punohet me te dhënat personale dhe të mbrohen të dhënat personale.	Të sigurohet që personeli marrin trajnim për atë se si të punohet me të dhënat personale dhe të	Zyra e Kryetarit/Njësia e Burimeve Njerzore	2025	Zyrtari përgjegjës i caktuar nga komuna për mbrojtjen e të dhënave personale, ka ndjekur trajnime profesionale për këtë fushë	E Realizuar	Ligjet dhe aktet tjara nënligjore	Gjatë vitit, njësia e personelt e harton planin e trajnimeve dhe përes atij plani zyrtarët	Të vazhdohet me trajnimet për zyrtarët përgjegjës.

		mbrohen të dhënat personale,						përgjegjës i ndjekin trajnimet e nevojshme.	
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Arsimi Publik	Rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve	Planifikimi me kohë i DKA-së për kuadro arsimore	DKA / Shkollat	2025	Janë njoftuar të gjitha institucionet arsimore për planifikim të kuadrove arsimore janar – dhjetor 2025, me qëllim që me kohë të shpallen vendet e lira të punës	E Realizuar	Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullorja (QRK) nr. 19/2024, UA-MASHT nr. 05/2021 dhe UA-MASHT nr. 05/2015 UA – nr. 22/2013	Mungesa e zyrtarëve në DKA mund të ndikojë në ofrimin e shërbimeve, duke krijuar vonesa ose vështirësi në organizimin e brendshëm arsimor dhe administrativ.	DKA nuk duhet të shpallë konkurse për rekrutim të stafit mësimor, fillimisht, duhet të sistemohen mësimdhënësit që mbesin tepriçë teknologjike si pasojë e rënies së numrit të nxënësve dhe fuzionimin e klasave mësimore si dhe shkollave sipas UA – nr. 08/2015 për fuzionimin e shkollave nën numrin e nxënësve
	Pamundësia e planifikimit adekuat për numrin e	Njoftimi i drejtorëve të shkollave sipas informatave që kanë.	DKA / Shkollat	2026	Kemi angazhuar mësimdhënës me orë mbi normë për mbulimin e orëve mësimore për	Pjesërisht e Realizuar	Raportet mjekësore, Udhëzuesi nr. 652 të datës	Momentalisht kemi 5 mësimdhënës me gjendje të	Marrja e masave për zëvendësimet adekuate nga

lehonave dhe
pushimeve tjera
sipas Ligjit të
Punës nr. 04/L-
212

mësimdhënësit me
gjendje të rëndë
shëndetësore dhe rastet
tjera në mungesë të
mësimdhënësve

01.04.2022 nga
MASHTI

rëndë
shëndetësore,
dhe vështërsi në
mbulimin e
orëve mësimore

stafi ekzistues të
cilët kanë
mungesë të
normave,
shpallja e
konkurseve me
kohë të caktuar.
Planifikimi i
kuadrit për
mësimdhënësit
me gjendje të
rëndë
shëndetësore.

Mungesa e
çerdheve publike
ne komune për
të mbuluar
numrin e
fëmijëve në
institucione
publike.

Planifikimi ne
kodet buxhetore

MASHT/
MFPT/
DKA/
MSHT

2026

Planifikimi buxhetor,
Identifikimi i parcelave si
pronë shoqërore dhe rritja e
numrit për kuadër mësimor

Pjesë e
Realizuar

Rritja e kërkesave
për arsim,
ndryshimet në
sistemin arsimor
dhe reformat e
vazhdueshme në
përputhje me
Planin Zhvillimor
Komunal të
Arsimit 2025-
2027.

Vështirësi në
zbatimin e
reformave
arsimore mund
të pengojnë
implementimin
e reformave dhe
përmirësimin e
nevojshëm në
sistemin
arsimor. Kjo
mund të çojë në
një stagnim të
zhvillimit të
arsimit dhe në
mosarritjen e
standardeve të
pritura.

Rritja e
burimeve
njerëzore në
DKA,
Monitorimi dhe
vlerësimi i
vazhdueshëm i
sistemit arsimor,
krijimi i
mekanizmave të
monitorimit dhe
vlerësimit të
përformancës
për të
identifikuar herët
problemet për të
mundësuar
zgjidhje të
shpejta dhe
efikase.

	Mungesa e burimeve njerëzore, zyrtarëve arsimor për inspektim nëpër institucione arsimore	Mungesa e zyrtarëve arsimor	Kryetari/ Njësia për burime njerëzore/ DKA/ Shkollat	2026	Përmirësimi i kushteve të punës dhe pagave, krijimi i mundësive për zhvillim profesional dhe trajnime, përmirësimi i rekrutimit dhe procedurave të punësimit	Pjesërisht e Realizuar	Rritja e kërkesave për arsim, ndryshimet në sistemin arsimor dhe reformat e vazhdueshme në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027.	Vështirësi në zbatimin e reformave arsimore mund të pengojnë implementimin e reformave dhe përmirësimin e nevojshëm në sistemin arsimor. Kjo mund të çojë në një stagnim të zhvillimit të arsimit dhe në mosarritjen e standardeve të pritura	Rritja e burimeve njerëzore në DKA, Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i sistemit arsimor, krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të performancës për të identifikuar herët problemet për të mundësuar zgjidhje të shpejta dhe efikase
	Kontrata kolektive e arsimit në Kosovë	Planifikimi i buxhetit	MASHT / MFPT/ DKA/ MSHT	2026	Përmirësimi i pagave dhe kushteve të punës, zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës, dialogu social dhe bashkëpunimi me sindikatat, programet e avancimit profesional	Pjesërisht e Realizuar	Kontratë kolektive e arsimit në Kosovë nr. 105 datë 22.01.2021	Mungesa buxhetore nëpër komuna ka krijuar konteste gjyqësore për realizimin e të drejtave nga kjo kontratë, për pagesën e	Angazhimi në dialog me qeverinë dhe ministrinë e arsimit dhe financave për të adresuar çështjet e ngritura në kontratën

								shujtave ditore, jubilarë, inflacioni, pagesa për kualifikim dhe shkollim, etj.	kolektive dhe realizimi i obligimeve për stafin mësimor.
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Turizmi dhe Zhvillimi Ekonomik	Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal.	Përditësimi si dhe dokumenteve strategjike për zhvillimin ekonomik të komunës;	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	2026	DTZHE-ja për vitin 2025 ka bërë hartimi, rishikimi, përditësimi e dokumenteve strategjike të turizmit, si dhe gjatë vitit 2024 ka hartuar strategjinë e Zhvillim Ekonomik Lokal e cila është e zbatueshme gjere ne vitin 2029	Pjeserisht e Realizuar	LIGJI NR. 08/L-074 PËR TURIZMIN	Mos serioziteti i aktereve per te dhene, mungesa e manaxhimit të procedurave, thjeshtësimi i procedurave dhe per ti formuluar ne perpikmeri keto dokumente	Pjesëmarrja e ekspertëve të fushës në përpilimin e dokumenteve strategjike nga ekspert që merren me lëmit përkatëse
	Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente	Rishikimi i prioritetëve të zhvillimit ekonomik të komunës; Licencimi i zonës ekonomike, Mbeshtetje financiare per organizata joqeveritare me ane te thirrjes publike	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	2026	DTZHE gjatë vitit 2025 me qëllim të përmbushjes së objektivave gjatë planifikimit buxhetor ka siguruar pjesëmarrjen e të gjithë palëve relevante në përgatitjen e hartimit dhe caktimit të prioritetëve për zhvillimin lokal. Gjatë përgatitjes së hartimit, takimet janë realizuar në mënyrë transparente ku pjesëmarrës ishin akterët nga zhvillimi ekonomik: shoqatat, bizneset, ojq-të si dhe	Pjeserisht e Realizuar	RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE	Sa i përket transparencës besoj që Komuna jonë ka arritur që ti eliminoj vështirësit themelore	Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioritetëve për zhvillimin lokal

					akterët nga fusha e turizmit: hoteleria, agjensionet turistike, gastronomia, ojqtë dhe shoqatat turistike, etj. Të gjitha palët patën mundësi për propozime / ide për dy fushat turizëm dhe zhvillim ekonomik.				
	Kualifikimi i panjafueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal.	Të sigurohet personale adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal; Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, të rritet numri i stafit	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	2025	Edhe në këtë vitë 2025 sfida vazhdon në mungesë të personelit adekuat profesional për zhvillim ekonomik lokal	E Realizuar	chrome-extension://efaidnbmnribpcajpcglelef indmkaj/https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/08/Vendimi-dhe-Strategjia-per-Zhvillim-Ekonomik-Lokal-per-Komunen-e-Prizrenit-2024-2029-Shq.pdf	Vështirsi themelore është numri i vogël i stafit në turizëm dhe zhvillim ekonomik	Shtimi i stafit që de të përfshihen në kuadër të turizmit është masa më e duhur e cila duhet marr dhe shikohet me seriozitet
	Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal	Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik	2025	DTZHE gjatë vitit 2025 me qëllim të përmbushjes së objektivave është duke bërë kontrollimin dhe raportimin e rregullt për zbatimin e aktiviteteve të cilat janë duke implementuar projektet	E Realizuar	chrome-extension://efaidnbmnribpcajpcglelef indmkaj/https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/08/Vendimi-dhe-Strategjia-per-Zhvillim-Ekonomik-Lokal-per-Komunen-e-Prizrenit-2024-2029-Shq.pdf	Nuk kemi bashkëpunime të kënaqshme me akteret lokal të turizmit për një zhvillim të qëndrueshëm	Kërkohej përkushtim dhe epërpikmëri për secilin investim dhe secilin aktivitet që merret në kuadër të turizmit lokal

Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Ofrimi i Shërbimeve në Shëndetin Publik	Mos funksionimi i AISH	Shtirja e rrjetit të internetit si dhe pajisja me PC e të gjitha njësive shëndetësore; Trajnimi i stafit për përdorim të sistemit	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	2026	Planifikimi i blerjes së PC-së për nevojat e institucioneve dhe planifikimi i hapjes së konkursit të SISH	Pjesërisht e Realizuar	Verifikimi i këtij projekti përmes zyrës së prokurimit dhe NJMBNJ	Mungesa e infrastrukturës vështirësit për shtirje të rrjetit të internetit sidomos nëpër fshatra	
	Pagesat për shërbime shëndetësore të dokumentuara në mënyrë manuale	Krijimi i programeve për inkasim elektronik për participimet për shërbimet shëndetësore	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	2026	Përfundimi i procedurës tenderuese dhe shpallja e fituesit për instalimin e programit të faturimit nëpër institucionet e KPSH	Pjesërisht e Realizuar	Verifikimi i këtij projekti përmes zyrës së prokurimit	Mungesa e rrjetit të internetit nëpër institucionet e KPSH dhe PC	
	Mungesa e stafit të mjaftueshëm për ofrim të shërbimeve	Blerja e shërbimeve shëndetësore përmes kontraktorëve të jashtëm, rekrutimi i stafit	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	2025	Shpallja e tenderit për blerje të shërbimeve shëndetësore si dhe rekrutimi i stafit sipas kodeve të lira	E Realizuar	Verifikimi i këtij projekti përmes zyrës së prokurimit dhe NJMBNJ	Mungesa e kodeve të mjaftueshme buxhetore të mjaftueshme për të rekrutuar staf të rregullt si dhe zgjatja e ankesës në OSHP lidhur me blerjen e shërbimeve shëndetësore	
	Mungesa e stafit të mjaftueshëm për ofrim të shërbimeve	Blerja e shërbimeve shëndetësore përmes kontraktorëve të jashtëm; Rekrutimi i stafit	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	2026	Shpallja e tenderit për blerje të shërbimeve shëndetësore si dhe rekrutimi i stafit sipas kodeve të lira	Pjesërisht e Realizuar	Verifikimi i këtij projekti përmes Zyrës së Prokurimit dhe NJMBNJ	Mungesa e kodeve të mjaftueshme buxhetore për të rekrutuar staf të rregullt si dhe zgjatja e ankesës në OSHP lidhur	

		sipas kodeve të ndara						me blerjen e shërbimeve shëndetësore	
Subvencione, grante dhe bursa	Mos zbatimi i rregulloreve komunale dhe të ministrisë për ndarjen e subvencioneve	Trajtimi i kërkesave bazuar në rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve	Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF	2025	Krijimi i komisionit për trajtim dhe respektimi i afateve dhe kritereve sipas rregulloreve	E Realizuar	Verifikimi i procesverbaleve të komisionit dhe vendimeve për mbështetje financiare	Nuk ka	
Subvencione, grante dhe bursa	Mungesa e monitorimit	Nuk nevojitet monitorim							
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Shërbimet Publike dhe Licencimi I tyre	Menaxhimi i pamjaftueshëm i rrezikut në menaxhimin e mbeturin	Rritja e rrezikut në menaxhimin e mbeturinave; përmirësimi i kornizës strategjike me hartimin dhe miratimin e një rregulloreje komunale të Menaxhimit të Mbeturinave; sigurimi i kontrolleve strikte dhe i llogaridhënies së operatorëve;	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Mjedisit	2025	Sektori I mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave në kuadër të kontratave për shërbime të rregullta, ka zhvilluar edhe projekte tjera për arritjen e një standardi më të mirë për mjedisin.	E Realizuar	Ende nuk kemi ndonjë procedurë për të prezantuar	Nuk kemi vështirësi në realizimin e kontratave	Menaxhimi I Mbeturinave e mbuluar nga komuna nuk bën reciklimin 3R e cila parashihet në Planin Master, por shpresojmë në projektet e ardhshme

	Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve	Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit të cilat parandalojnë vendime subjektive	Drejtorja e Shërbimeve Publike, Sektori I Komunikacionit	2025	Sektori I Komunikacionit kryen Licencimin e linjave për transportin publik, I cili përfshin periudhën të licencimit për çdo 5 vjet.	E Realizuar	Kompanitë të cilat aplikojnë për Licencë duhet të sjellin dokumentet sipas kriterëve për licencim. Sektori I komunikacionit bën verifikimin e dokumenteve dhe më pas inspekton në terren lokacionet e kompanive dhe harton raportin final.	Nuk ka vështirësi në realizimin e projektit	Përkundër investimeve të ndërmarrura nga DSHP, ende nuk kemi një infrastrukturë të mjaftueshme për plotësimin e standardeve për një transport të qëndrueshëm.
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizimit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillimi Rural	Mungesa e kriterëve të qarta në ndarjen e subvencioneve për zhvillimin e bujqësisë dhe sektorëve tjerë	Te zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika kurrë të korruptive; Pjesëmarrja e shoqërive civile	Kryetari i Komunës, Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	2025	Janë marrë të gjitha veprimet që janë të miratuara me rregullore të kuvendit komunal	E Realizuar	Linku ku mund ta gjeni rregulloren.....e publikuar në uebfaqen e APK-se të tyre.	Mos mundësia e zbatimit të ligjeve për mbrojtjen e tokave bujqësore si rezultat e mosdefinimit të qart të kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal.	Koordinimi dhe definimi i qartë i kompetencave të pushteteve (atij Qendror dhe Lokal) në mënyrë që të ndalet degradimi i mëtutjeshëm i tokave bujqësore si dhe rehabilitimi sistemeve eksistuese të

		ne vleresimin e kerkesave per ndarjen e subvencioneve-perfshirja e shoqerive civile ne subvencione dhe shoqatat e fermerve							ujitjes që ato të jenë funksionale
	Kontrolli jo efikas mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit të përdorimit të tokave	Rritja e kontrollit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe përdorimit të tokës	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rur	2025	Jan realizuar te gjitha procedurat ne perputhshmeri me rregulloren e kuvendit komunal.Nr 001/11-201 dt:03.01.2024	E Realizuar	Linku ku mund ta gjeni rregulloren.....e publikuar ne ueb faqen e APK-se .	Gjithqka ne rregull.	Nuk ka pas veshtirsi, rregullorja eshte zbatu me perpikmeri
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Prokurimi Publik	Mungesa e stafit te kualifikuar për menaxhimin e kontratave (E ndarë në drejtori përkatëse)	Caktimi i stafit profesional, të certifikuar dhe ofrimi i trajnimeve për menaxhim të kontratave	Drejtoria e Administratës	2026	Stafi profesional ka ndjek trajnime dhe është certifikuar.	E Realizuar	Lidhet dhe aktet nënligjore dhe aktet komunale	Në munges të stafit profesional jemi të detyruar të caktojm menagjer te kontratave mbështetës teknik dhe zyrtar tjerë	Rekomandojm trajnime të herë pas hershme
	Vonesa në hartimin e planit të prokurimit	Hartimi me kohë i kërkesave nga programet dhe nën programet, angazhimi i stafit me kohë në hartimin e planit të prokurimit	Programet dhe nën programe	2025	Nga neglizhenca e drejtorive perkatese te cilat nuk l dorezojne me kohe planin e prokurimit	E Realizuar	Sipas afateve ligjore	Neglizhenca nga niveli qendror me ate lokal	Rekomandojme bashkepumim me adekuatë ne mes te nivelit qendrorë dhe lokale.

	Përgatitja jo efikase e specifikave teknike të projekteve nga njësia e kërkesës	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit. Hartimi i projekteve detale.	Të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Prokurim	2026	Përgatitja e specifikave teknike të projekteve është përmirësuar në këtë drejtim duke marrë masa sepse ka të kontraktuara OE për projekte të ndryshme	Pjesërisht e Realizuar	Ligjet dhe aktet tjara nënligjore	Vështirësit nga drejtoritë perkatëse sepse nuk ka njerez adekuat ne drejtorit perkatëse.	Rekomandojme qe njesis e kerkeses te caktojne njerez adekuat ne pergaditjen e specifikave teknike
	Caktimi i zyrtarëve jo profesional për menaxhim të kontratave	Caktimi i zyrtarëve profesional sipas fushës së kontratës së lidhur; Trajnimi i zyrtarëve	Zyra e Kryetarit; Njësia e personeli	2026	Disa drejtori e kan zbatuar këtë rekomandim nga njesi e kërkesë	Pjesërisht e Realizuar	Ligji I prokurimit dhe rregullorja e prokurimit publik	Dejtorit paketaresë te cilat kane projekte te ndryshme , apo furnizime nuk caktojn menaxher adekuate , per ate po ka mangesi dhe arsyeimi I tyre eshte se nuk kemi staf te mjaftushem adekuat te rekrutuar.	Rekomandojme njesis e kerkeses dhe kryetarin e komunes qe te caktojn njerez adekuat dhe profesional ne menaxhimin e kontratave.
	Komisionet jo profesionale për vlerësimin e ofertave	Caktimi i zyrtarëve profesional për vlerësim të ofertave	Të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Prokurimi	2026	Kjo pike ka mbetur pothuajse e njejt arsyeja nga drejtorit përkatës sepse nuk kemi mjaft staf profesional	Pjesërisht e Realizuar	Ligji I prokurimit dhe rregullorja e prokurimit publik	Ka filluar qe edhe njesia e kerkeses te kete parasyshe qe komisinne te vleresimit te ofertave te eskoj njereze me adekuat per lemin e caktuar te prokurimit.	Rekomandojm qe drejtorit qe te caktojn njerez adekuat te profileve te puneve apo sherbimeve te realizuara
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet

Inspektimet	Planifikimi jo i duhur i inspektimeve	Plani vjetor i punës për Drejtorinë e Inspektionit duhet të jetë i bazuar në metodë bazuar në risk si dhe të përfshinë informacione relevante	Drejtoria e Inspektionit, Udhëheqësit e Sektoreve	2025	Është realizuar Ka filluar zbatimin e kësaj rregullore Rregullorja për Shërbime Publike Komunale në Komunën e Prizrenit	E Reavizuar	Web faqen e komunes, K.PZ-001/011-73507-RR Data e publikimit 04.07.2024 https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=92634	Ka filluar kordinimi Me Zyrene Inspektorit të Përgjithshëm ZIP Jan caktuar dy zyrtar për komunikim me ZIP Kërkohej nga ZIP që të bëhet trajnimi i Inspektoreve në Prizren për zbatimin e ligjit për Inspektime	Të mbështet DI me trajnime nga ana e ZIP-it .
	Kapaciteti i pamjaftueshem profesional i inspektoreve	Angazhimi ne trajnime profesionale	Drejtoria e Inspektionit, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerzore	2026	Stafi ka kërkuar nga drejtori që përmes Njësia Së Menaxhimit të Burimeve Njerzore dhe nga Zyrene Inspektorit të Përgjithshëm ZIP që të na u mundesoj trajnimet profesionale	E Parealizuar	Verifikimi pranë Zyres së Inspektorit të Përgjithshëm ZIP Përmes Imellit Zyrtar	Mungon interesimi nga ana e Zyres se Burimeve Njerezore.	Të mbështet DI me trajnime nga ana e ZIP-it dhe nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve
	Stafi i pamjaftueshem, numri i vogel i inspektoreve	Rekrutimi i numrit te mjaftueshem dhe profesional i inspektoreve	DI dhe Zyra e Burimeve Njerezore	2026	Mungojn 5 Inspektor për shkak se jan pensionuar	Pjeserisht e Realizuar	DI, ZBNJ, web faqja e komunes	Janë pensionuar disa inspektor ndërsa puna i është ngarkuar stafit ku po kemi edhe vështërsi në realizimin e planit	Të hapen konkurset Për rekrutimin e stafit të ri
	Transparence jo e plote per punen e njesise se inspektimit	Te publikohet lista vjetore e bizneseve te cilat jane inspektuar dhe realizimin e	DI dhe Zyra per informim	2026	Janë hartuar raportet vjetore, dhe te dërguara ne zyrën e kryetarit	Pjeserisht e Realizuar	Web faqja e komunes	Nuk ka vështërsi të theksuara	Të vazhdohej me transparenc

		planit ne perqindje.							
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor	Mangësi në rregullativën e brendshme që lidhet me fushën e planifikimit urban, rural, ndërtim dhe banim	Ligjet, aktet nënligjor e në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës	Kryetari i Komunës; Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm	2026	Hartimi dhe zhvillimi i rregullativës së brendshme duke përcaktuar kritere të qarta, të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural, dhe që parandalojnë veprimet subjektive	E Realizuar	Web faqja e Komunes ne kuader te drejtorise se urbanizmit dhe Pl.hapsinor	Mungesa e stafit mund të sjellë vonesa në miratimin e dokumenteve, projektet e ndërtimit, planifikimin urban dhe shërbimet ndaj qytetarëve.	Punesimi stafit profesional ne fushat qe k ate bej urbanizmi dhe planifikimi
	Zbatim jo i plotë i rregullativës së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban, rural banim dhe ndërtim.	Ligjet, aktet nënligjor e në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës	Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Njësia e Burimeve Njerëzor	2026	Përforsim i stafit me specialistë të trajnuar në fushën e rregullativave Përmirësim i procedurave për të bërë më të thjeshtë dhe transparent procesin Bashkëpunim më i mirë me inspektorëve, urbanistëve dhe komunitetin	Pjesërisht e Realizuar	Web faqja e Komunes ne kuader te drejtorise se urbanizmit dhe Pl.hapsinor	Kushtet e punës dhe motivimi për të mbajtur personelin e kualifikuar Sistemi i shpërblimeve dhe incentivave	Trajnime për përditësim të njohurive dhe aftësive në fushën e urbanizmit dhe teknologjisë Zhvillim profesional për staf ekzistues
	Kuadro i panjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e	Të sigurohet personel shtesë adekuat profesional për	Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm,	2026		Pjesërisht e Realizuar	Ligjet, aktet nënligjor e në fuqi, dhe aktet e brendshme të komunës		

	zbatimit të dokumenteve për planifikim urban, rural, banim dhe ndërtim	planifikim urban dhe rural	Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore						
	Mungesa e kontroleve konsistente mbi ndërtimet (vend punishtet)	Shtimi I kontroleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje	Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm	2026	Nuk është ndërmare	E Përealizuar		Hapja e tenderit për natyrë të tillë të punës	Marrja e masave për shtim të kontrollit apo mbikqyrja nga ana e jashtme si organ mbikqyrës
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Mos definimi i qartë i Statusit të OJQ-ve	Në vazhdimësi të bëhet definimi i fushëveprimtarisë së OJQ-ve	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2025	Gjatë fazës së vlerësimit janë mbështetur/identifikuar OJQ-të vetëme fushëveprimtari Kulturë, Rini dhe Sport	E Realizuar	Aplikimet pranë DKRS	Aplikimi i mjaftueshëm	Rritja e aplikimeve për definim të qartë të statutit
	OJQ-të dhe organizatat sportive nuk zgjidhen rregullisht	Ndërmarrja e masave për përzgjedhjen e rregullt të OJQ-ve dhe organizatave sportive	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2026	Do të mbështeten programe për avancimin e OJQ-ve rinore përmes mbështetjes financiare dhe jo vetëm	Pjesërisht e Realizuar	Mbështetja financiare për OJQ për vitin 2025	Mungesa e pamjaftueshme e mjeteve financiare	Rekomandohet rritja e buxhetit për subvencionim
	Plani 1 vjeçar i punës së DKRS, me objektivat dhe	Përmirësimi i kornizës strategjike për Kulturë, Rini	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2025	Organizimi i dëgjimeve publike me OJQ	E Realizuar	Informimi përmes e-mail adresave	Pjesëmarrja e vogël e OJQ-ve në dëgjime publike	Rekomandojmë rritjen e pjesëmarrjes së përfaqësuesve

	dikastere Avancimi i bashkëpunimit me OJQ	dhe Sport duke hartuar Planin e Veprimit komunal për Rini, Kulturë dhe Sport. Të gjitha aktivitetet kulturore sportive dhe rinore, të planifikohen me buxhet për çdo vit nga DKRS-ja							të OJQ-ve në dëgjime
	Numri i pamjaftueshëm i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë për të rinj	Zbatimi i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë dhe fushat për të rinjtë	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2026	Rritja e mbështetjes për projekte në fushën e rinisë	Pjesërisht e Realizuar	Subvencionimi i OJQ-ve, ofrimi i hapësirave të DKRS-së për programe rinore	Aplikimi në masën e pamjaftueshme në fushën e rinisë	Rekomandohet të krijohen OJQ të reja në fushën e rinisë të cilat ofrojnë projekte kreative dhe të dobishme për të rinjtë.
Fusha e Rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masa e propozuar	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizmit	Veprimet e ndërmarra	Niveli i realizmit	Mjetet e verifikimit	Vështirësitë	Rekomandimet

Burimet njerëzore	Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm.	Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit.	Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive.	2026	Sipas legjislacioneve në fuqi është bërë planifikimi për vitin 2025 dhe është duke u plotësuar me staf sipas planifikimit dhe kërkesat e kryetarit.	Pjesërisht e Realizuar	Sipas ligjit për zyrtarët publik Nr.08/L-197 dhe akteve tjera nënligjore që e rregullojnë këtë fushë.	Nuk ka pasur vështërsi në implementim	Pasi që plani po realizohet me sukses nuk ka rekomandim
	Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve.	Të bëhet analiza e nevojave për trajnime; Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave; Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura.	Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive.	2026	Së bashku me planifikimin e personelit është bërë edhe planifikimi i trajnimeve për stafin adekuat dhe stafin në periudhë provuese e cila varet nga IKAP.	Pjesërisht e Realizuar	Sipas evidencave për trajnimet e mbajtura	Nuk ofrohen trajnime për të gjitha temat e planifikuara	Të ofrohen trajnime brenda institucionit
	Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës.	Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit.	Kryetari i Komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve.	2025	Stafi komunal është në informim të kodit të etikës pasi që sapo krijon marrëdhënie pune e pranojnë kodin e etikës dhe ligjet e aplikueshme.	E Realizuar	Kodi i etikës I Komunës së Prizrenit 01Nr.246120	Nuk ka pasur vështërsi në implementim	Nuk kemi rekomandime pasi procesi është i zbatueshëm.

Mungesa e informimit dhe mos raportimit të dhuratave nga qytetarët tek punëtorët e Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës).

Njësia për Burime Njerëzore krijon një regjistrim për dhuratave të pranuar nga nëpunësit; Të informohet stafit për rregullat e pranimi të dhuratave.

Njësia e Burimeve Njerëzore

2026

Punëtorët e Komunës janë informuar për obligimin ligjor që kanë për të deklaruar dhuratat e pranuar gjatë tërë vitit, dhe shumica kanë deklaruar për pranim ose mospranimi të dhuratave.

E Realizuar

RREGULLORE NR. 05/2024 PËR PRANIMIN DHE REGJISTRIMIN E DHURATAVE NGA PERSONAT ZYRTARË.

Nuk ka pasur vështirësi në informim.

Nuk kemi rekomandime pasi procesi është i zbatueshëm